



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 202, Datë 05.12.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SH.A PËR VITIN
2018**

Në mbështetje të neneve 16; 19 gërma “c/i” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 19 pika 1 gërma “c” ; neneve 21 dhe 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 05.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me kërkesën e OST sh.a për miratimin tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 6441 Prot., datë 23 Nëntor 2017 (protokolluar në ERE me nr. 758 Prot., datë 24 Nëntor 2017), OST sh.a, ka depozituar në ERE “Përlllogaritjen e Tarifës së Transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018”.
- Në respekt të nenit 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, afati maskimal i paraqitjes së aplikimit për tarifë duhet të ishte data 1 Shtator 2017, në mënyrë që të mundësohej vendimmarrja brenda muajit Dhjetor të vitit 2017.
- Aplikimi duhet të shoqërohej me analiza dhe argumenta për të gjitha shpenzimet operative të vitit ushtrimor të mbyllur dhe të audituar (2016) që do të shërbejë si vit testimi, analizat e shpenzimeve të pritshme për vitin 2017 dhe krahasimi me të ardhurat e kërkuara për vitin 2018. Këto informacione do të shërbejnë si bazë argumentuese në lidhje me të ardhurat e kërkuara për vitin 2018, por edhe për transparencë me palët e interesuara.
- Aplikimi duhet të plotësohet me analizat e llogaritjeve të Bases së Rregulluar të Aseteve (RAB) që nga viti 2014-2017 për të evidentuar dhe paraqitur në këtë mënyrë gjendjen dhe levizjet e asetëve të krahasuara me pasqyrat financiare përkatëse.

- Për efekt transparence dhe argumentimi aplikimi duhej te shoqerohej me paraqitjen në mënyrë analitike/të grupuara edhe llogaritjet e amortizimit për periudhën 2015-2017 si edhe analizat e llogaritjes së amortizimit të parashikuar për vitin 2018.
- Në lidhje me investimet e parashikuara për vitin 2018 OST sh.a krahas disbursimit te kredive për investimet duhet te jape ne menyre analitike dhe vlerat e investimeve qe priten te realizohen dhe te hyjne ne operim pergjate vitit 2018. Krahas nevojave per investime kompania duhet të paraqesi edhe efektin që këto investime do të sjellin në të ardhurat e kërkuara jo vetem për vitin 2018. Por edhe per periudhat e mëparshme 2016 e 2017.
- Mungesa e paraqitjes per miratim te Planit te Investimeve për vitin 2018, krahas aplikimit per tarifen e transmetimit per te njejten periudhe.
- Plotesimin e kerkeses per te ardhura te kerkuar me qellim mbulimin e kostove te borxhit për vitin 2018, me informacione dhe te dhena analitike ne lidhje me linjat e kredive dhe llogaritjet perkatese te kostos se borxhit per vitin 2018, si dhe analiza per kostot e realizuara ne fakt te borxhit për periudhën 2015-2017.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2018.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

Votimi i Antarëve të Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 202, Datë 05.12.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SH.A PËR VITIN
2018**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____